



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

RELACION

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR MENAXHIMIN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA PËR VITIN 2024

A. Baza ligjore.

- Ligjit 57/2020 “Për pyjet” neni 30, pika 3, 4, 5, 6.
- Ligjit 9693 datë 19.03.2007 i ndryshuar “Për fondin kullosor”.
- Ligji nr. 45/2019 datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.
- Ligjit Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- Ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” (ndryshuar me ligjin nr.69/2013, datë 14.2.2013; nr. 131/2014, datë 2.10.2014; nr. 68/2023, datë 21.7.2023).
- VKM -së nr.807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile”
- VKM-së nr.1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”,
- VKM -së nr. 433, Datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të kullotave publike , sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Bashkisë Durrës” e ndryshuar me VKM-në nr. 134 datë 03.03.2021.
- Urdhërit nr.43, datë 17.01.2023 për K.M.C.

B. Relatimi i çështjes.

Të nderuar këshilltarë !

Bashkia Durrës, paraqet kërkesën për hartimin e këtij plan menaxhimi për parandalimin dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2024. Ky plan menaxhimi hartohet në zbatim të detyrimeve dhe akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri si dhe përballimin e situatave emergjente.

Miratimi i këtij plani menaxhimi për zjarret në pyje e kullota ka për qëllim inspektimin, parandalimin, shuarjen e zjarreve, mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, si dhe zvogëlimin e riskut kur ndodhin këto zjarre. Origjina e këtyre zjarreve mund të vijë nga shkaqe natyrore, si dhe nga ato të shkaktuara nga dora e njeriut. Zjarret si fenomen përshkruhen si fatkeqësi natyrore pasi ndikojnë në jetën e përditëshme të njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin etj. Në kuadrin e transferimit të pyjeve dhe kullotave pranë Bashkive, struktura përgjegjëse harton këtë plan të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2024 duke u bazuar dhe në analizën e shkaqeve të zjarreve si dhe në faktorët që influencojnë në shkaktimin dhe përhapjen e zjarreve në territorin e bashkisë. Bashkia Durrës ka një relief fushor dhe kodrinor, pyjet në territorin e bashkisë tonë janë pyje të ulët, kryesisht cungishte e shkurre dhe shtrihen në zonën kodrinore. E gjithë zona që përfshihet brenda territorit administrativ të bashkisë është një rrezik për rënien e zjarreve në pyje dhe kullota. Gjatë vitit 2023 në fondin pyjor e kullosor nuk kemi raste të zjarreve në fondin pyjor kombëtar.

Shuarja e këtyre zjarreve është bërë nën drejtimin e personelit të M.Z.SH.-së Durrës. Në disa parcela me pyje dhe kullota nuk është e mundur të ndërhyhet me mjetet zjarrfikëse për shkak të terrenit dhe relievit natyror por ndërhyhet vetëm me fuqi puntore apo vullnetarë ose nga ajri. Në rastet kur zjarri është pranë fshatrave mjetet zjarrfikëse qëndrojnë në gadishmëri pranë banesave. Periudha e rënies së zjarreve në fondin pyjor e kullosor zakonisht është nga 15 Qershor deri më 15 Tetor. Pavarësisht nga përcaktimi i kohës së rënies së zjarreve, nuk përjashtohet mundësia e shfaqjes së tyre dhe në periudha të tjera, gjithmonë në varësi të kushteve atmosferike dhe ndikimit nga dora e njeriut. Ndër masat që merren nga Bashkia Durrës dhe Sektori i Pyjeve, për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri janë:

Në rast të shfaqjes së zjarreve në pyje e kullota do të organizohet i gjithë personeli pyjor, emergjencat civile, Njësitë Administrative së bashku me skuadrat zjarrfikëse vullnetare të ngritura më parë në bazë fshati me mjete të ndryshme dhe do të jenë të pranishme në vënd ku do të punohet për izolimin dhe shuarjen e zjarreve.

Drejtimin për shuarjen e zjarrit në pyje dhe kullota si fillim bëhet nga punonjësit e Njësisë Administrative, specialistët e pyjeve deri në mbërritjen e punonjësve të repartit të M.Z.SH.-së të cilët marrin drejtimin e këtij operacioni pasi janë më të specializuar. Operacioni për shuarjen e zjarrit në pyje dhe kullota vazhdon deri në izolimin dhe shuarjen e tij. Sipas rasteve të zjarrit (rëndësisë, përhapjes) do të shfrytëzohen të gjitha institucionet si reparte ushtarake dhe institucione shtetërore të cilat janë një burim i madh njerëzor për shuarjen e zjarreve në pyje, **duke mos harruar se burimi kryesor për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota është vetë komuniteti vendas.** Bashkia Durrës, Sektori i Pyjeve pas marrjes së njoftimit për rënien e zjarrit duke u nisur nga vendi ku ka rënë zjarri, përbërja e grumbullit pyjor, rreziku i qëndrave të banuara përcakton qartë organizimin e shuarjes së zjarrit. Krahas fondit pyjor që kemi në administrim do të jemi në gadishmëri dhe për raste të tjera jashtë fondit pyjor e kullosor duke marrë të gjitha masat e duhura për M.N.Z. Sipas përmasave të zjarrit do kërkojmë ndihmë për mjete nga institucione të tjera.

Lëvizja e mjeteve dhe burimeve njerëzore në drejtim të vëndit ku ka rënë zjarri, piknisjen e kanë nga institucioni kur bëhet fjalë për bashkëpunim institucional, nga fshati kur bëhet fjalë për komunitetin vendas, si dhe nga subjekti privat kur bëhet fjalë për pyjet privat. Ky itenerar i lëvizjes së mjeteve dhe burimeve njerëzore do të jetë gjithmonë në bazë të konfiguracionit të terrenit. Ndër masat e duhura për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota janë dhe ndërhyrjet me punime si pastrime, krasitje, rrallime në të dy anët e rrugëve kryesore dhe ato sekondare që ndodhen në brendësi të fondit pyjor. Një masë tjetër që ndihmon në parandalimin e zjarreve në pyje është dhe rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në brendësi të fondit pyjor e kullosor kryesisht në pyjet e fshatrave. Për këtë nga ana e Bashkisë të vihet në dispozicion të sektorit të pyjeve dhe repartit të M.Z.SH.-së mjete fadromë për rehabilitimin e infrastrukturës rrugore. Bashkia Durrës dhe Sektori i Pyjeve do të zhvillojnë takime sensibilizuese me të gjithë kryetarët e fshatrave, kryetarët e skuadrave zjarrfikëse që janë ngritur në bazë fshati, në bashkëpunim dhe me M.C.R (emergjencat civile), M.Z.SH.-në duke ju shpjeguar për rëndësinë e madhe që kanë pyjet e kullotat dhe se nga ana jonë duhet të punohet më shumë për parandalimin, luftimin, shuarjen e zjarreve kur kemi raste të rënies së tyre. Gjithashtu do të vendosen postera nëpër qendrat e banuara në vendet më të dukshme për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

Përsa më lartë dhe në zbatim të akteve ligjore, ngelet në gjykimin tuaj miratimi i këtij drafti strategjik i cili paraprakisht është miratuar në mënyrë hierarkike nga institucioni i Bashkisë Durrës.

Faleminderit!

**Drejtore
Alneida Rroshi**

Konceptoi: A.Kapidani,S.Maksuti.